

Këshillimore kundër duhanit : Vështirë mundë ti bindim mjekët për dorëheqje

Nga Qendra e shëndetit publik, ku zbatohen këshilla, thonë se ky është procesi i përpiktë edhe për dorëheqësin edhe për këshillimorin. Rezultate nuk mund të ketë menjëherë.



Tetëmbëdhjetë profesionist të shëndetit, mjekë në praktik të përgjithshme, shumë specialist me profile të ndryshme, staf administrativ, teknik dhe laborant mjekësor, janë ndërmjet personave që në dy muajt e fundit vizituan Qendrën e shëndetit publik Shkup, ku ishte e hapur këshillimorja për dorëheqje nga duhani. Udhëheqësja e repartit në mjekësi sociale në Qendër ku gjendet këshillimorja për dorëheqje nga duhani doktoresha Vesna Spirova, tregon se nuk është arritur suksesi të cilën e kanë pritur por shton se procesi i dorëheqjes është i vështirë dhe i përpiktë edhe për dorëheqësin edhe për këshillimorin. Nuk shpresojmë as që në dy ditët e para dikush të ngritët dhe të thotë unë dua të fillojë me terapi për dorëheqje nga duhani, mirëpo ne do të vazhdojmë të punojmë me këtë grup që më vonë do të ofroj edhe terapi individuale, e cila vijon si fazë e fundit nga ky proces, thotë d-r Spirova.



Vlerësimi i Qendrës është se këto persona më vonë në mesin ku punojnë në institucionet tjera, do ti motivojnë më shumë kolegët që të japin dorëheqje nga duhani dhe në atë mënyrë të fitojnë besimin e plotë të pacientët ku ata shohin shembull për shëndetin e tyre dhe mënyrën për një jetë të shëndetshme. Këshillimorja nga dje është e hapur për të gjithë qytetarët që do të vendosin të kërkojnë ndihmë dhe me anë të ligjëratave dhe edukimit të vendosin për të lënë cigaren, ose të fillojnë me terapi për të dhënë dorëheqje nga duhani. Zakonet te njerëzit ndryshohen, popullsia e re urbane e cila krijohet në vitet e fundit është e arsimuar, të interesuar për ndryshimin e stilit të jetës dhe kjo na inkurajon që të besojmë se këshillimorja do

të jetë e vizituar nga një numër i madh i qytetarëve të cilët kanë menduar se si të japin dorëheqje, dhe një numër i madh i tyre do të kenë sukses edhe në qëllimin përfundimtar. Lërja e cigareve thekson d-r Spirova.



Ajo thotë se nuk pret që të gjithë qytetarët të jenë shumë të vetëdijshëm për shëndetin e tyre dhe rreziqet nga varësia, por për atë shkak apelon ata të cilët janë në mëdyshe ta vizitojnë këshillimoren.

Sa kohë pasi që të zgjoheni pini duhan,sa është intervali ndërmjet dy cigareve,ndizni duhan në situata të vështira, disa nga këto pyetje që do të formohet profili se çfarë duhanpirës jeni. Zbulimi i profilit tuaj i punonjësve në Qendrën e shëndetit publik, të cilët do të udhëheqin këshillimoren për heqje dorë nga duhani, do të ju ndihmojë për tu individualizuar terapinë tuaj,e cila do të ju ndihmojë për të lënë duhani. Këshillimi është vullnetar dhe anonim. Së pari paraqiten faktet nga ajo që do të thotë përdorimi i përditshëm i duhanit dhe cilat janë pasojat, si dhe për ata të cilët do të shfaqin dëshirën për të dhënë dorëheqje në qoftë se ata nuk mund ta bëjnë atë vet, do të ju ofrohet terapi në formë këshillimi, me çamçakëzë,shurup i hundës si dhe mjete ndihmë për të dhënë dorëheqje nga pirja e duhanit, si fazë përfundimtare e procesit.



Secili duhanpirës duhet të kalojë mes procesit të tërë që terapia të jetë e suksesshme. Ajo fillon me këshillim. Deri sa personi është i interesuar seriozisht për të dhënë dorëheqje nga duhani, i bëhet një testim që të përcaktohet në cilën grup përket.-përdorues të nikotinës,të varur,ata të cilët për herë të parë kanë nderur cigare ose disa herë kanë nderur cigare. Në bazë të testimit. Kalohet në terapi individuale.